FOL lëvizja

Duke Mbështetur Qeverisjen e Mirë dhe Qytetarinë Aktive
Supporting Good Governance and Active Citizenry

Monitoruesi i Korrupsionit

Raport mbi Monitorimin e Aktiviteteve Institucionale në Luftë Kundër Korrupsionit

Korrik-Shtator 2012

Prishtinë, 2012

Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive	3
Prokuroria e Kosovës	4
Këshilli Prokurorial i Kosovës	4
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	5
Policia e Kosovës	6
Agjencia Kundër Korrupsion	6
Qeveria e Kosovës	7
Kuvendi i Kosovës	8
Falënderime	9
Rreth FOL-it	9

Lista e Akronimeve/Shkurtesave

AKK	– Agjencia Kundër Korrupsionit
DHKEK	– Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit
EULEX	- Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë
KGJK	– Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	– Këshilli Prokurorial i Kosovës
MD	– Ministria e Drejtësisë
PK	– Policia e Kosovës
SKK PV	– Strategjia Kundër Korrupsion dhe Plani i Veprimit

Përmbledhje Ekzekutive

Ky raport i rregullt tremujor dëshmon pasivitetin e institucioneve publike në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit. Të gjeturat e këtij raporti tregojnë se institucionet përgjegjëse për luftimin e korrupsionit nuk janë duke përmbushur misionin për të cilin janë themeluar, duke mos ndërmarrë veprime të mjaftueshme dhe konkrete për uljen e shkallës së lartë të korrupsionit në Republikën e Kosovës.

Përgjatë periudhës raportuese gjykatat e rregullta komunale të Kosovës kanë zgjidhur gjithsej 30 lëndë: 15 në kuadër të Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare, 4 në kategorinë Marrje e Ryshfetit dhe 11 në Dhënie të Ryshfetit. Në fund të periudhës raportuese kanë mbetur të pazgjidhura 183 lëndë: 118 në kategorinë Shpërdorim i Pozitës Zyrtare, 45 në kategorinë Marrje e Ryshfetit dhe 20 në Dhënie të Ryshfetit. Gjatë këtij harku kohor gjykatat kanë trashëguar gjithsej 173 lëndë: 126 nga kategoria Shpërdorim i Pozitës Zyrtare, 26 nga kategoria Marrja e Ryshfetit dhe 21 nga kategoria Dhënia e Ryshfetit. Gjatë kësaj kohe gjykatat kanë pranuar në punë gjithsej 40 lëndë: 7 në kategorinë Shpërdorim i Pozitës Zyrtare, 23 në kategorinë Marrje e Ryshfetit dhe 10 në kategorinë Dhënie e Ryshfetit. Ndërkaq si lëndë në punë që janë në proces të shqyrtimit janë gjithsej 213: 133 në kategorinë Shpërdorim i Pozitës Zyrtare, 49 në Marrje të Ryshfetit dhe 31 në kategorinë Dhënie e Ryshfetit.

Sipas statistikave të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion (DHKEK), rezulton se për kategorinë Shpërdorim të Pozitës Zyrtare ose autorizimit, 23 raste janë nën hetime, 25 raste janë dërguar në Prokurori me kryerës të njohur, 5 raste janë dërguar me raport në Prokurori, 11 janë arrestuar dhe ndaj 58 të dyshuarve është ushtruar kallëzim penal. Për kategorinë Marrje të Ryshfetit, 2 raste janë nën hetime, 6 raste janë dërguar në Prokurori me kryerës të njohur dhe kundër 1 të dyshuari është ngritur kallëzim penal. Në kuadër të kategorisë Dhënie Ryshfeti, 4 raste janë dërguar në prokurori me kryerës të njohur, po për këtë vepër penale janë arrestuar 5 persona dhe kundër 4 të dyshuarve tjerë është ushtruar kallëzim penal. Gjatë këtij tremujori Policia e Kosovës, ka konfiskuar 19,700.00 Euro, 980,300.00 dollarë si dhe çeka në vlerë 2,300,000.00 euro.

Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) gjatë këtij tre mujori ka qenë e fokusuar në nxjerrjen e dy raporteve analitike:a) “Analizë mbi ndjekjen dhe gjykimin e rasteve korruptive në Kosovë”; dhe b) “Raportin për rastet e iniciuara për mos deklarim të pasurisë dhe sanksioneve”.

Qeveria e Kosovës përgjatë këtij intervali kohor ka nxjerrë gjithsej 97 vendime. Nga këto vendime vetëm 2 kanë qenë të ndërlidhura direkt apo indirekt me luftimin e korrupsionit në vend: a) Përfshirja e Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Korrupsion 2012-2016 në Planin e Dokumenteve Strategjike 2012; si dhe b) Aprovimi i projektligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale.

Kuvendi i Kosovës nuk është treguar aspak produktiv në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Nga 8 seanca plenare sa ka mbajtur gjithsej, në asnjërin prej tyre nuk është diskutuar për shkallën e korrupsionit në institucionet publike, duke u shënuar si institucioni më pasiv në luftë kundër korrupsionit.

Sistemi Prokurorial[1]

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës me 23 korrik të këtij viti ka ngritur aktakuzë ndaj Kolë Puka (ish gjyqtar në gjykatën komunale të Klinës) si dhe avokatit Avdullah Robaj. Të dytë akuzohen për kryerjen e veprës penale Shpërdorim i Pozitës Zyrtarë ose i Autorizimit[2]. Të pandehurit akuzohen se kanë përfituar më shumë se 71.000.00 euro duke dëmtuar 4 persona. Prokuroria komunale në Pejë po më 23 korrik të këtij viti ka ngritur aktakuzë ndaj Abaz Honsiq (polic kufitar) për marrje të ryshfetit. Me 7 gusht 2012, Prokuroria e Gjilanit ka ngritur aktakuzë kundër Bajram Vokshi, punëtor teknik i pylltarisë në Drejtorinë për Bujqësi të Autoritetit Pyjor Komunal në Kamenicë. Sipas aktakuzës i pandehuri rezulton të ketë kryer vepër penale marrje të ryshfetit.[3] Me 12 shtator 2012, Prokuroria e Qarkut në Prishtinë, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, kanë arrestuar 4 persona me dyshimin se kanë kryer vepër penale falsifikim i parave.[4]

Këshilli Prokurorial i Kosovës

Duke u bazuar në rregulloren e Këshillit Prokurorial të Kosovës, ky Këshill mbanë takime të rregullta 1 herë në muaj, e sipas nevojës ato mbahen edhe më shpesh.[5] Gjatë tre mujorit (Korrik, Gusht, Shtator) Këshilli është mbledhur 7 herë. Takimi i parë është mbajtur me 20 korrik, gjatë të cilit takim Kryeprokurori, respektivisht Kryetari i Këshillit z. Ismet Kabashi, ka caktuar koordinatorë të veçantë për fusha të caktuara në kuadër të këtij Këshilli, si dhe ka kërkuar më shumë përgjegjësi nga stafi prokurorial në përmbushjen e obligimeve që dalin nga udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave. Po gjatë muajit Korrik KPK[6] ka mbajtur një takim të përbashkët me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, gjatë të cilit takim është shqyrtuar ankesa e parashtruar nga z. Kadri Begolli, ish drejtor i Zyrës së Prokurorit Disiplinor, në lidhje me procesin e përzgjedhjes së drejtorit të Zyrës së Prokurorit Disiplinor. Po atë ditë KPK-ja ka aprovuar Kodin e Etikës për anëtarët e KPK-së, Kodin e Etikës për prokurorë, si dhe Kodin e Etikës për stafin mbështetës të sistemit prokurorial. Në këtë takim është shqyrtuar po ashtu edhe rekomandimi i komisionit të themeluar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës për caktimin dhe transferimin e prokurorëve në Prokurorinë e Apelit, e cila do të fillojë së funksionuari më 1 janar 2013. Në takimin e parë të mbajtur për muajin gusht është diskutuar për projektligjin për pagat e funksionarëve publikë. Sipas Këshillit projektligji në fjalë shpërfillë parimin e barazisë së pushteteve, degradon pozitën dhe autoritetin e sistemit prokurorial dhe nuk respekton as Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Po në këtë takim është shqyrtuar dhe aprovuar Rregullorja për Caktimin dhe Transferimin e Stafit Mbështetës të sistemit prokurorial. Me këtë rregullore caktohen procedurat për caktimin dhe

[1] Në kuadër të Prokurorisë i analizojmë të gjitha veprat që sanksionohen me kapitullin XXIX të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.
[2] KPK: neni; 339; paragrafi 1 dhe 3.
[3] Prokuroria e Shtetit. http://www.psh-ks.net/?page=1,8,274
[4] Kodi Penal I Kosovës, neni 244; paragrafi 1
[5] Këshilli Prokurorial I Kosovës; Rregullorja e Punës; Më gjerësisht shih: http://www.psh-ks.net/repository/docs/Rregullorja_e_punes_se_KPK-se.pdf
[6] Këshilli Prokurorial i Kosovës

transferimin e personelit mbështetës nga prokuroritë komunale dhe të qarkut në prokuroritë themelore dhe në atë të apelit të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në strukturën organizative të përcaktuar me Ligjin për Prokurorin e Shtetit. Me 14 shtator është mbajtur takimi i radhës, në të cilin është diskutuar për Rregulloren për Punën e Komisionit Disiplinor, të cilën Sekretariati i KPK-së obligohet t'ia dërgojë Këshillit Gjyqësor të Kosovës për harmonizim. Gjithashtu, në këtë takim është diskutuar edhe për strategjinë e KPK-së lidhur me Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës dhe ri-strukturimin e EULEX-it. Në takimin tjetër Këshilli ka nxjerrë vendim për caktimin e numrit të nevojshëm të punonjësve mbështetës të sistemit prokurorial bazuar në strukturën e re organizative të prokurorive. Në takimin e fundit për muajin shtator Këshilli Prokurorial i Kosovës ka miratuar plotësim-ndryshimin e Rregullores për caktimin dhe transferimin e prokurorëve. Me këtë rregullore caktohen kriteret dhe procedurat për caktimin dhe transferimin e prokurorëve, duke u bazuar në riorganizimin e prokurorive të përcaktuara me Ligjin për Prokurorinë e Shtetit. Po në këtë takim është vendosur për shpalljen e njoftimit të brendshëm për aplikim nga prokurorët e interesuar për caktim/transferim në Prokurorinë e Apelit. Në këtë takim është diskutuar njëherazi rreth objektivave strategjike të Planit Strategjik 2013-2015, si dhe është themeluar grupi punues për plotësim-ndryshimin e Rregullores së Punës së Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës[7]

Përgjatë periudhës raportuese, gjykatat e rregullta komunale të Kosovës kanë zgjidhur gjithsej 30 lëndë: 15 në kuadër të Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare, 4 në kategorinë Marrje e Ryshfetit dhe 11 në Dhënie të Ryshfetit. Ndërkaq, në fund të periudhës raportuese kanë mbetur të pazgjidhura 183 lëndë: 118 në kategorinë Shpërdorim i Pozitës Zyrtare, 45 në kategorinë Marrje e Ryshfetit dhe 20 në Dhënie të Ryshfetit.. Gjatë këtij harku kohor gjykatat kanë trashëguar gjithsej 173 lëndë: 126 nga kategoria Shpërdorim i Pozitës Zyrtare, 26 nga kategoria Marrja e Ryshfetit dhe 21 nga kategoria Dhënia e



[7] Në kuadër të monitorimit tonë të Gjykatave të rregullta të Republikës së Kosovës I analizojmë vetëm tri kategoritë kryesore që kanë të bëjnë me veprat penale me natyrë korruptive; Shpërdorimi I pozitës zyrtare, marrja e ryshfetit, dhënia e ryshfetit.

Ryshfetit. Gjatë periudhës korrik, gusht, shtator janë pranuar në punë gjithsej 40 lëndë: 7 në kategorinë Shpërdorim i Pozitës Zyrtare, 23 në kategorinë Marrje e Ryshfetit dhe 10 në kategorinë Dhënie e Ryshfetit. Ndërkaq si lëndë në punë që janë në proces të shqyrtimit janë gjithsej 213: 133 në kategorinë Shpërdorim i Pozitës Zyrtare, 49 në Marrje të Ryshfetit dhe 31 në kategorinë Dhënie e Ryshfetit.

Policia e Kosovës

Gjatë tremujorit të tretë Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion (DHKEK) rezulton se për kategorinë Shpërdorim të Pozitës Zyrtare ose autorizimit, 23 raste janë nën hetime, 25 raste janë dërguar në Prokurori me kryerës të njohur, 5 raste janë dërguar me raport në Prokurori, 11 janë arrestuar dhe ndaj 58 të dyshuarve është ushtruar kallëzim penal. Për kategorinë Marrje të Ryshfetit, 2 raste janë nën hetime, 6 raste janë dërguar në Prokurori me kryerës të njohur dhe kundër 1 të dyshuari është ngritur kallëzim penal. Në kuadër të kategorisë Dhënie Ryshfeti, 4 raste janë dërguar në prokurori me kryerës të njohur, po për këtë vepër penale janë arrestuar 5 persona dhe kundër 4 të dyshuarve tjerë është ushtruar kallëzim penal.



Gjatë këtij tremujori Policia e Kosovës, respektivisht Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Kundër Korrupsion, ka konfiskuar 19,700.00 Euro, 980,300.00 dollarë si dhe çeka në vlerë 2,300,000.00 euro.

Agjencia Kundër Korrupsion

Agjencia Kundër Korrupsion (AKK) përgjatë periudhës raportuese është përqendruar në rastet e konfliktit të interesit, si dhe ka punuar në nxjerrjen e dy raporteve apo analizave. Të dyja raportet pasqyrojnë punën e saj si mekanizëm i specializuar në luftimin e korrupsionit. Në raportin e parë të publikuar, "Analizë mbi ndjekjen dhe gjykimin e rasteve korruptive në Kosovë"[8], Agjencia është munduar të bëjë një përmbledhje të saktë të të dhënave të statistikave në lidhje me atë se si institucionet që kanë për mision luftën kundër korrupsionit iu kanë qasur këtij problemi dhe se si ato i kanë trajtuar dhe ndjekur kryerësit e veprave

[8] Agjencia Kundër Korrupsion; http://akk-ks.org/repository/docs/0.07_Raporti_me_statisikat_2012_versioni_perfundimtar_shqip.pdf

korruptive apo edhe dënuar ata.[9] Sipas Agjencisë ky raport do të vlejë për të gjithë ata që janë të interesuar të dinë se sa po luftohet korrupsioni në Kosovë.

AKK-ja gjatë kësaj periudhe raportuese ka përmbyllur edhe procesin e deklarimit të pasurisë të zyrtarëve të lartë publik. Këtë vit numri i zyrtarëve të lartë publikë që kanë qenë të obliguar që ta deklarojnë pasurinë ka qenë 3657. Nga ky numër, obligimin ligjor e kanë përmbushur 3354 ose 91.71%, ndërsa numri i atyre që nuk e kanë deklaruar pasurinë është 261 zyrtarë të lartë publikë. Prej tyre, 6 zyrtarë të lartë kanë ofruar tek AKK-ja dëshmi që gjenden jashtë vendit apo janë të sëmurë, kurse sipas AKK-së numri i atyre të cilët e kanë deklaruar pasurinë pas afatit ligjor është gjithsej 36. Por, bazuar në nenin 17 të ligjit për Deklarim të Pasurisë[10], AKK-ja ka bërë të ditur se i ka adresuar lëndët e të gjithë atyre që nuk e kanë deklaruar pasurinë në afatin ligjor tek gjykatat për kundërvajtje. Këto të fundit kanë filluar shqiptimin e dënimeve me gjobë për mos respektuesit e afatit ligjorë për deklarimin e pasurisë.

Ndërkaq raporti tjetër analitik i Agjencisë ka të bëjë përkitazi me rastet e iniciuara nga AKK për mos deklarimin të pasurisë nga ana e zyrtarëve të lartë publikë, si dhe efikasiteti i gjykatave për sanksionimin e tyre për vitin 2010 dhe 2011.[11] Sipas kësaj analize del se në vitin 2010 nga numri i përgjithshëm i zyrtarëve të lartë publik që kanë pasur për obligim deklarimin e pasurisë, 1483 zyrtarë të lartë publik kanë përmbushur obligimin ligjor, ndërsa 77 zyrtarë të lartë publikë nuk kanë respektuar Ligjin nr. 03/L-151.[12] Ndaj të gjithë këtyre zyrtarëve të lartë publikë AKK-ja ka iniciuara procedura kundërvajtëse në Gjykatat kompetente për Kundërvajtje. Shuma e përgjithshme e dënimeve të shqiptuara nga Gjykatat në shkallën e parë është: 25,450.00 €uro, ndërsa në shkallën e dytë është: 2,600.00 €uro.

Ndërkaq në vitin 2011 nga numri i përgjithshëm i zyrtarëve të lartë publikë që kanë pasur për obligim deklarimin e pasurisë, 1742 zyrtarë të lartë publikë kanë përmbushur obligimin ligjor, ndërsa 88 zyrtarë të lartë publik nuk kanë respektuar Ligjin nr. 03/L-151. Shuma e përgjithshme e dënimeve të shqiptuara nga Gjykatat në shkallën e parë është: 22,580.00 €uro, ndërsa në shkallën e dytë është: 5,500.00 €uro.[13]

Qeveria e Kosovës

Qeveria e Kosovës përgjatë tre mujorit të tretë të këtij viti ka nxjerrë gjithsej 97 vendime. Nga këto vendime vetëm 2 sosh kanë qenë të ndërlidhura direkt apo indirekt me korrupsionin në vend. Në mbledhjen e mbajtur me 1 gusht 2012 qeveria ka marrë vendim për përfshirjen e Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2012-2015 në Planin e Dokumenteve Strategjike 2012. Përfshirja e SPV përbën një vendim të rëndësishëm në luftë kundër korrupsionit, duke qenë se është dokumenti më i lart strategjik për

[9] Analizë mbi ndjekjen dhe gjykimet e rasteve korruptive në Kosovë; AKK; Korrik 2012, faqe 2

[10] Gazeta Zyrtare, Ligji për Deklarimin e Pasurisë (04/L-050)https://gazetazyrtare.rksgov.net/Documents/Ligji%20per%20deklarimin%20e%20pasurise%20se%20zyrtarve%20te%20larte%20(shqip).pdf

[11] Agjencia Kundër Korrupsion: http://www.akk-ks.org/?cid=1,4,532

[12] Ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë

[13] Më gjerësisht shih: Analizë lidhur me rastet e inicuara për mos deklarimin e pasurisë; http://akk-ks.org/repository/docs/Analiza.pdf

luftimin dhe parandalimin e aferave korruptive në institucionet e vendit. Kjo strategji ishte miratuar fillimisht nga Qeveria qysh në muajin janar 2012[14], për t'u dërguar më pas për votim në Kuvend.[15] Me 19 vota pro, 39 kundër, 6 abstenime, "Strategjia dhe Plani i Veprimit Kundër Korrupsion 2012-2016" nuk u pat miratuar.

Vendimin e dytë, të cilin e ka nxjerrë Qeveria e Kosovës në fushën kundër-korrupsion është ai i miratuar më 7 gusht 2012, e i cili ka të bëjë me "projektligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale".[16] Ky projektligj[17] përbën njërin ndër projektligjet që është diskutuar më së shumti, si nga ana institucionale, po aq edhe nga ajo e shoqërisë civile. Me 24 korrik të këtij viti Ministria e Drejtësisë pati organizuar një debat publik me përfaqësues të shoqërisë civile, gjyqësorit, prokurorisë, Policisë së Kosovës, Agjencisë Kundër Korrupsion, Ambasadës Amerikane dhe EULEX-it.[18] Ky projekt-ligj ka hasë në kritika të shumta nga Forumi Këshillues i OJQ-ve për Pakon Ligjore Kundër-Korrupsion. Ky Forum në vazhdimësi ka dhënë rekomandime për këtë projektligj, por të cila nuk janë marrë për bazë nga Ministria e Drejtësisë. Ndër rekomandimet e këtij forumi janë:

a. duhet ndryshuar emri i draftligjit, i cili në të njëjtën kohë reflekton në fushëveprimin dhe qëllimin e këtij draft-ligji;
b. kualifikimi "pasuritë e fituara me kryerjen e veprës penale", të ndryshohet me "pasuritë e fituara në mënyrë të paligjshme"(edhe për rastet kur nuk ka të bëjë me vepër penale);
a. pasuria e përfituar në mënyrë të paligjshme të vërtetohet nga i dyshuari, e jo sipas detyrës zyrtare;
b. do të duhej të zbatohej edhe për pasuritë e fituara në mënyrë të paligjshme të personave të dyshuar, të krijuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, pra të lejohej retroaktiviteti tij; si dhe
c. krijimi i mekanizmave të veçantë brenda institucioneve ekzistuese (polici, prokurori, gjykata) me qëllim të zbatimit më efikas të legjislacionit të kësaj fushe.[19]

Mungesa e vullnetit të qeverisë për ta luftuar korrupsionin është evidentuar edhe në Raportin e Studimit të Fizibilitetit.[20]

Kuvendi i Kosovës

Kuvendi i Kosovës, si organi më i lartë përfaqësues dhe demokratik në vend, nuk është treguar aspak produktiv në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Nga 8 seanca plenare sa ka mbajtur gjithsej, në asnjërin prej tyre nuk është diskutuar për shkallën e korrupsionit në

[14] http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_mbledhjes_se_56-te_te_Qeverise_2011.pdf
[15] http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_s_2012_04_19_10_4168_al.pdf
[16] Qeveria e Kosovës, vendimi 02/86
[17] Ministria e Drejtësisë; http://www.md-ks.org/?page=1,8,759
[18] KohaDitore,24.07.2012http://www.koha.net/?page=1,13,108606

[19] Preportr, 26 shtator 2012 http://preportr.com/sq/Republika/Ligj-pr-mbrojtjen-e-hajnave-207
[20] Raporti; Komunikata e Komisionit për Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit mes Bashkimit Evropian dhe Kosovës http://www.mei-ks.net/repository/docs/Dokumenti_punues_i_Komisionit_Evropian_mbi_SF_per_MSA_mes_BE-se_dhe_Kosoves.pdf

institucionet publike, dukë u shënuar si institucioni më pasiv për këtë fushë.

Falënderime

Ky Raport është produkt dhe rezultat i kontributit të një ekipi të përkushtuar, si nga stafi i lëvizjes FOL, por edhe nga bashkëpunëtorët e jashtëm. Lëvizja FOL falënderon publikisht të gjithë personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti. Të gjitha Raportet e Lëvizjes FOL mbi Aktivitetet e Institucioneve Publike të Kosovës në Luftë kundër Korrupsionit janë të publikuara në këtë ëebfaqe: www.monikorr.org

Rreth Lëvizjes FOL

Lëvizja FOL angazhohet për të fuqizuar ndikimin qytetar në vendimmarrje, për qeverisje të përgjegjshme dhe efikase. FOL është thellësisht e përkushtuar që të punojë në përmirësimin dhe arritjen e niveleve më të mira të përfaqësimit qytetar në jetën publike. FOL punon për qeverisje të mirë dhe të bazuar në parimet demokratike, për institucione të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse, si dhe për zbatim dhe hartim të ligjit me pjesëmarrje. Prandaj, shpenzimi i fondeve publike, konfliktit të interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale, si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL. Në përmbushje të këtyre qëllimeve, FOL mëton të luftojë apatinë dhe indiferencën qytetare si dhe ta bëjë më aktiv dhe më të dëgjueshëm zërin e qytetarit; ta bëjë atë pjesë aktive të interesit të komunitetit dhe përherë të gatshëm që t'i kundërvihet abuzimit, keqpërdorimit, korrupsionit dhe formave tjera deformuese të qeverisjes.

Kontakto:

Andrea Gropa 35, 100000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Mob: +377 (0) 44 131 542
Ueb: levizjafol.org
E-mail: info@levizjafol.org